

Vendim: Nr. 01/08/16.008

Data: 01.08.2016

## POLITIKA E TRANSFERIT DHE NJOHJES SË KREDIVE NË CE

1. Cactus Education ka të drejtën të pranojë ose të refuzojë transferimin apo njohjen e kredive në tërësi ose në një pjesë të tyre, nga cilido institucion tjetër arsimor ose ofrues i trajnimeve me certifikime duke përfshirë certifikimet nga vendorët industrialë.
2. Transferi i kredive pranohet vetëm nga institucionet e akredituara nga organet ose organizatat regullative ose profesionale nga shteti në të cilin janë fituar ato kredi si dhe nga vendorët industrialë për të cilët edhe CE ka programe të trajnimit dhe arsimimit.
3. Njohja dhe pranimi i kredive nga institucionet e tjera dhe ekuivalentimi i certifikatave, diplomave dhe certifikatave industriale në kredi në CE bëhet vetëm:
  - për programet aktuale të ofruar në CE, dhe për programet e ofruara në 3 vitet e kaluara;
  - në bazë të përputhjes së përmbajtjes së kurseve të kryera në institucionet tjera me përmbajtjet e lëndëve korresponduese në programet e CE, duke përfshirë këtu rezultatet e pritura të nxënies për ato lëndë, në masën prej së paku 70%.
4. Drejtori ose udhëheqësi i departamentit emëron një komision për shqyrtimin e aplikacionit për transferin e kredive. Komisioni përbëhet nga Kordinatori i cilësise, mësimdhënësi i lëndës dhe një mësimdhënësi i departamentit.
5. Drejtori ose Dekani / Shefi i departamentit, në bashkëpunim me zyrtarin e financave të CE do të caktojë një tarifë për të mbuluar koston e punës së komisionit, shpenzimet administrative të CE dhe shpenzimet e tjera të zbatueshme për transferimin e kredive. Kjo pagesë është e pakthyeshme. Komisioni do të fillojë shqyrtimin e aplikacionit për transferin e kredive vetëm pasi të jetë paguar tarifa e caktuar.



Address // Rexhep Mala 27, Prishtina, Kosovo  
Phone // +381 (0)38 22 63 61  
Email // [info@cactus.education](mailto:info@cactus.education)  
Web // [www.cactus.education](http://www.cactus.education)

6. Aplikacioni për transferin e kredive dorëzohet pranë zyrës administrative të CE. Aplikimi mund të bëhet përmes emailit, postës ose dorëzimit të dokumenteve në letër në zyrën administrative të CE. Aplikacioni për transferin e kredive duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme:

- Kopja e dokumentit, certifikatës ose diplomës, të lëshuar nga institucioni ose vendori;
- Kopja e dokumentit përcjellës shpjegues (psh “diploma suplement”) nëse është lëshuar;
- Kopja e transkriptit të notave ose përqindjes së rezultateve, ose transkripti i provimit certifikues të vendorit;
- Kopja e syllabusit për lëndën për të cilën aplikohet për transfer të kredive.

Aplikuesi duhet të dorëzojë në CE për verifikim dëshmitë origjinale të dokumenteve të mësipërme ose kopjet e noterizuara.

Komisioni mund të kërkojë edhe materiale tjera shtesë dhe shpjegime nga aplikuesi ose mund të shohë të nevojshme të kontaktojë me institucionin apo vendorin që i ka dhënë kreditë fillimisht.

6. Transferi i kredive, respektivisht lëshimi i certifikatës apo vërtetimit mbi pranimin e kredive nga CE, bëhet në bazë të raportit të komisionit për transferin e kredive. Komisioni mund të rekomandojë pranimin e plotë ose të pjesshëm të kredive, ose mund të refuzojë të pranojë plotësisht kreditë . Kopjet e raportit të komisionit dhe certifikatës së lëshuar nga CE do të ruhet në arkivin e CE dhe do të regjistrohen pranë autoriteteve në bazë të akteve normative në fuqi.

Kjo politikë hyn në fuqi menjëherë dhe mbetet në fuqi deri në sjelljen e një vendimi për ndryshimin e saj.

Drejtori i shkollës

---

Kastriot Fazliu

